



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Kërko



LIVE



Kryefaqja

Kuvendi ▾

Struktura ▾

Dokumentacioni ▾

Diplomacia parlamentare ▾

Integrimi europian ▾

Lajme

Postuar më 27/06/2024

Kuvendi u mbledh në seancë plenare, miratoi tre projektrezoluta dhe 2 projektligje





Nën drejtimin e Kryetares, znj. Lindita Nikolla, Kuvendi u mbledh në seancën plenare të radhës. Në nisje të saj u mbajt një minutë heshtje në nderim të viktimave së genocidit ndaj shqiptarëve të Çamërisë në vitin 1945. Kryeparlamentarja Nikolla njoftoi se kryetari i grupit parlamentar socialist, z.Bledi Çuci, ka kërkuar futjen në rendin e ditës të dy projektvendimeve që lidhen me zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve. Kërkesa u hodh në votim dhe u miratua me shumicë votash.

Kryetarja znj.Nikolla njoftoi më tej se deputeti z.Asllan Dogjani ka paraqitur një kërkesë për interpelancë me Kryeministrin Edi Rama lidhur me mungesën e reagimit të qeverisë ndaj grabitjes së pronës publike dhe private të qytetarëve. Z. Dogjani paraqiti kërkesën, e cila u rrëzua me shumicë votash dhe seanca vazhdoi punimet sipas rendit të ditës.

Seanca pyetje-përgjigje

Gjatë punimeve plenare u zhvillua një seancë pyetje-përgjigjesh kërkuar nga deputetja e opozitës, znj. Erisa Xhixho për ministren e Arsimit dhe Sportit, znj. Ogerta Manastirliu, në lidhje me bursat e studentëve të degëve prioritare. Në parashtrimin e kërkesës, znj. Xhixho duke iu referuar VKM-së të qershorit 2023 për heqjen e mesatares për përfituesit e bursës, u shpreh se vetëm 1/4 e studentëve të regjistruara në degët prioritare kanë përfituar nga mbështetja financiare. Znj. Xhixho kërkoi informacion nga ministrja se përse nuk kanë përfituar të gjithë studentët dhe mbi ç'bazë ligjore janë përjashtuar nga lista e përfituesve.

Në përgjigjen e saj, ministrja e Arsimit dhe Sportit, znj. Ogerta Manastirliu, nënvizoi se buxheti i parashikuar për bursat prioritare për vitin 2024 është rreth 1.5 milionë euro dhe sqaroi vendimmarrjen e qeverisë për të rritur interesin e studentëve për të studiuar në degë me interes kombëtar. Znj. Manastirliu nënvizoi rëndësinë e gjetjes së mekanizmave për të ridimensionuar ofertën universitare, programet e studimit, në mënyrë që t'i përshtaten tregut dinamik të punës, ndryshimeve të teknologjisë, etj. Znj. Manastirliu sqaroi se vendimi i marrë dy vite më parë ka qenë një incentiv që studentët, të cilët studiojnë në degë si: mësuesi, kimi, fizikë, matematikë, inxhinieri navale apo e minierave, inxhinierinë e pyjeve apo bujqësi, të mbështeteshin financiarisht me bursa sa paga minimale. “Vitin e parë përfituan studentë të cilët në këto degë u futën për arsye të vendosjes së një mesatareje, vitin e dytë ishte shpjegimi se vendimi i qeverisë në instrumentin që përllogariste kishte vendosur që heqja e mesatares të garantonte më shumë interes për të përthithur në këto degë që janë vendosur si degë prioritare”, sqaroi znj. Manastirliu.

Projektrezolutat

Diskutimet parlamentare nisën me raportimin e veprimtarisë vjetore të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, Gjendjen

e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtarinë e ERE-s përgjatë vitit 2023. Z. Tomi Frashëri, Kryetar i AKEP, z.Genci Mamani, Drejtor i Përgjithshëm i ASD dhe z.Petrit Ahmeti, Kryetar i ERE, raportuan në Kuvend lidhur me veprimtarinë e kryer gjatë vitit 2023 të institucioneve që drejtojnë. Kryetari i Këshillit Drejtues të AKEP, z.Tomi Frashëri në fjalën e tij gjatë paraqitjes së raportit, theksoi se AKEP ka shtuar vëmendjen mbi evoluimin e tre prej parametrave kryesorë që institucioni mban në mbikëqyrje: çmimet e pakicës, treguesit e cilësisë së shërbimit dhe nivelin e investimeve. Përmes rezolutës prej 8 pikash të paraqitur nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Kuvendi i rekomandoi AKEP që për vitin 2024 të fokusohet ndër të tjera në: Analizën e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme dhe nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike mobile, duke trajtuar edhe futjen në treg e MVNO; të kërkojë marrjen e masave shtesë nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, për të bërë të mundur garantimin e integritetit dhe pacenueshmërinë e rrjeteve dhe infrastrukturave kritike të tyre, si dhe ruajtjen e të dhënave personale të përdoruesve të tyre; krahas analizës së tregjeve me shumicë të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme AKEP, duke ju referuar edhe praktikave më të mira evropiane të kryej një studim mbi vlerësimin e mundësive dhe impaktit të hyrjes së MVNO-ve në tregun e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme si dhe sigurimin e një kuadri rregullator të favorshëm për hyrjen e MVNO-ve në treg, etj. Projektrezoluta u miratua nga Kuvendi me vota 73 pro, 14 kundër dhe 0 abstenim.

Diskutimet vijuan me shqyrtimin e raportit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për veprimtarinë e vitit 2023. Kreu i ASD-së vuri në dukje se përgjatë vitit që lamë pas agjencia i ka përqendruar përpjekjet e saj në drejtim të realizimit dhe përmbushjes së rekomandimeve të rezolutës të Kuvendit të Shqipërisë dhe se jatë vitit 2023, ASD ka siguruar depozitat e vendosura nga depozituesit në 11 banka dhe 9 shoqëri kursim krediti. Përmes një projektrezolute prej 5 pikash të paraqitur nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i rekomandoi ndër të tjera ASD që përgjatë vitit 2023 të fokusohet në: intensifikimin e punës në drejtim të sigurimit të gatishmërisë institucionale për kompensimin efektiv të depozituesve, nëpërmjet ushtrimit të testimeve, të simulimeve teknike dhe bashkëpunimit me bankat dhe SHKK anëtare të skemës në këtë drejtim; të rrisë transparencën përmes publikimit të të dhënave dhe raporteve statistikore në formate dhe platforma lehtësisht të përdorshme nga publiku i gjerë; të bashkëpunojë me Bankën e Shqipërisë dhe palët e tjera të përfshira në proces

me qëllim identifikimin dhe administrimin e rreziqeve kibernetike, etj. Projektrezoluta u miratua nga Kuvendi me 72 vota pro, 14 kundër dhe 2 abstenim.

Rendi i ditës vijoi me shqyrtimin e raportit të gjendjes së Sektorit të Energjisë dhe Veprimtarinë e ERE-s përgjatë vitit 2023. Z. Petrit Ahmeti, Kryetar i ERE theksoi se ndër objektivat e vet kryesore të institucionit ka qenë promovimi i krijimit të një tregu të brendshëm konkurrues të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit, si dhe bëri një bilanc të situatës së prodhimit të energjisë elektrike të realizuar për vitin 2023. Gjatë diskutimeve, deputetët e opozitës ngritën shqetësimin për situatën e rrjetit elektroenergjetik në vend, vonesat në ngritjen e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), etj. Përmes rezolutës prej 12 pikash të paraqitur nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Kuvendi rekomandoi që për vitin 2024 të fokusohet ndër të tjera në: dhënien e kontributit për të luajtur një rol proaktiv për të bërë të mundur rritjen e volumit të tregtuar në Bursë dhe pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm në fushën e energjisë, si dhe të vijojë punën për realizimin e bashkimit të tregjeve të energjisë së një dite më parë si një sfidë e rëndësishme e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e efikasitetit të impianteve të prodhimit të energjisë së rinovueshme të Shqipërisë në tregun rajonal dhe me gjerë; gjatë miratimit të planit të investimeve të shoqërive t'i kushtojë vëmendje të veçantë investimeve në zonat turistike të vendit, zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit, për më tepër duke pasur parasysh ritmet me të cilat po rritet numri i turistëve në vend, duhet të shoqërohet edhe me investime në fushën e energjisë, etj. Projektrezoluta u miratua nga Kuvendi me 73 vota pro, 14 kundër dhe 0 abstenim.

Projektligjet

Seanca vijoi punimet me shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 65/2014, “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes””. Gjatë prezantimit të projektligjit ministri i Mbrojtjes, z.Niko Peleshi, sqaroi se ndryshimet ligjore do të ndikojnë në përmirësimin e veprimtarisë së kësaj agjencie dhe qartësimin e veprimtarisë informative bazuar në legjislacion të qartë dhe të harmonizuar me legjislacionin kombëtar, marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese dhe ato përgjegjëse për sigurinë kombëtare, me partnerët ndërkombëtarë

dhe me strukturat ndërkombëtare me të cilat AISM bashkëpunon. Projektligji u miratua me 73 vota pro, 15 kundër dhe 0 abstenim.

Punimet vijuan me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërqeveritare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Francës, për kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri”. Gjatë diskutimeve u vlerësua se marrëveshja përshkruan një kuadër gjithëpërfshirës për bashkëpunimin strategjik ndërmjet dy vendeve, duke u dhënë prioritet projekteve që synojnë modernizimin e infrastrukturës, veçanërisht në sektorët e menaxhimit të ujit, trajtimit të mbetjeve, energjisë dhe transportit, të cilat mund të çojnë në përmirësime të rëndësishme në cilësinë e jetës dhe efikasitetin ekonomik, etj. Projektligji u miratua me 87 vota pro, 0 kundër dhe 1 abstenim.

Seanca vijoi me shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 45, datë 11.05.2016 “Për vullnetarizmin””, nismë e deputetes së opozitës znj. Ina Zhupa. Në cilësinë e nismëtares, znj. Zhupa bëri prezantimin e detajuar të projektligjit duke theksuar risitë që sjell në krahasim me ligjin ekzistues të vitit 2016. Znj.Zhupa theksoi se ndryshimet synojnë të bëhet i mundur krijimi dhe përpunimi i një baze të plotë të dhënash, në nivel kombëtar, mbi vullnetarizmin, e cila do të administrohet nga AKPA, si dhe do të forcohet detyrimi i ofruesve të vullnetarizmit për të mbajtur dhe depozituar të dhëna të sakta e të plota për vullnetarët. Projektligji u rrëzua me 16 vota pro, 68 kundër dhe 2 abstenim.

Projektvendimet

Seanca plenare shqyrtoi dy projektvendimet:

Projektvendim “Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve sipas ligjit nr.115/2016 ‘Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë’”, i cili mori 61 vota pro, 2 kundër dhe 10 abstenim. Për shkak se lista e kandidatëve nuk u arriti të marrë shumicën e votive të kërkuara procedura do të përsëritet.

-Projektvendim “Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve sipas ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë’”, i cili mori 62 vota pro, 4 kundër dhe 4 abstenim. Për shkak se lista e